HOSHGJÉLDËN..!

SHPIRTI

ME KONSULLIN E ARABISË SAUDITE NË ATHINË

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 20 - Nr. 1 (227), Janar, 2022

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

Hoshgjéldën..!

Për mua, në pozitën e Myftiut të Shkodrës, patjetër, që premtimi i presidentit Erdoğan për restaurimin e Xhamisë së Plumbit, mbetet një fjalë e rëndësishme dhe një ëndërr shekullore, të cilën e kam vlerësuar që në momentin e parë të dhënies së saj, dhe për të cilën, kam falënderuar publikisht edhe kryeministrin e vendit tim gjatë vizitës së tij në Xhaminë e Plumbit!

MYFTIU VIZITOI PRIJËSIT E KRISHTERË TË SHKODRËS

Në kuadër të vizitave dhe takimeve ndërfetare, ditën e mërkurë, më 26 janar 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, vizitoi prijësit e krishterë të komunitetit katolik dhe atij ortodoks në Shkodër.

Fillimisht, në Arqipeshkvinë Shkodër-Pult, Myftiu u prit nga Arqipeshkvi, Mons. Angjelo Massafra, me të cilin zhvilloi një bashkëbisedim të ngrohtë, duke vënë theksin tek domosdoshmëria e aktiviteteve të përbashkëta në dobi...

(f. 3)

MYFTIU TAKOI IMAMËT NË PRAG TË TRE MUAJVE TË MIRË

Paraditën e së enjtes, më 13 janar 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, takoi imamët e Myftinisë Shkodër, me të cilët diskutoi për imazhin e imamit dhe misionin që ai mban mbi supe.

Myftiu theksoi se imami është pikë referimi në shoqëri dhe duhet të përpiqet me të gjitha mundësitë e tij për të ruajtur këtë pozitë të lartë dhe përgjegjësitë e tij. Takimi, që është i pari në prag të Tre Muajve të Mirë 1443 ...

(f. 16)

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

HOSHGJÉLDËN..!

Për mua, në pozitën e Myftiut të Shkodrës, patjetër, që premtimi i presidentit Erdoğan për restaurimin e Xhamisë së Plumbit, mbetet një fjalë e rëndësishme dhe një ëndërr shekullore, të cilën e kam vlerësuar që në momentin e parë të dhënies së saj, dhe për të cilën, kam falënderuar publikisht edhe kryeministrin e vendit tim gjatë vizitës së tij në Xhaminë e Plumbit!

Vizitat e njerëzve të mëdhenj dhe miqve të shtrenjtë, janë përherë burim kënaqësie dhe një lloj ripërtëritjeje e rendit e shendit, pa përmendur begatinë e harenë që na përfshin pa përjashtim.

E tillë është edhe vizita e presidentit të Turqisë, Sh.T.Z. Rexhep Taip Erdoğan, ditën e hënë, më 17 janar 2022, në vendin tonë.

Është një lajm i mirë për vendin tonë dhe forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të domosdoshme dhe shekullore që ne kemi me njëri-tjetrin, si dy popuj, që për shekuj e shekuj ndamë së bashku fatet, nën çatinë e madhe të hilafetit osman, ku arnautët dhe turqit, bashkë edhe me kombësi të tjera, udhëhoqëm botën dhe shpërndamë gjithandej qytetërimin e vlerave tona të mrekullueshme islame dhe njerëzore!

Është lajm i mirë për të sotmen dhe të ardhmen, për marrëveshjet dhe mirësitë e bashkëpunimeve turko-shqiptare në sfera të ndryshme, në dobi të vendit dhe mirëqenies së shqiptarëve pa dallim!

Për mua, në pozitën e Myftiut të Shkodrës, patjetër, që premtimi i presidentit Erdoğan për restaurimin e Xhamisë së Plumbit, mbetet një fjalë e rëndësishme dhe një ëndërr shekullore, të cilën e kam vlerësuar që në momentin e parë të dhënies së saj, dhe për të cilën, kam falënderuar publikisht edhe kryeministrin e vendit tim gjatë vizitës së tij në Xhaminë e Plumbit; që patjetër duhet të ndjehet i lumtur për këtë fat të madh në jetën dhe karrierën e tij politike!

Edhe për këtë fakt, Reisi mirë se të vijë në një tokë e në një vend që e duan dhe e vlerësojnë më shumë sesa shfaqet; që e nderojnë dhe e besojnë, si rrallëherë president në botë!

Shembulli dhe botëkuptimet tona islame prej shekujsh janë të lidhura ngushtë me Turqinë, e kështu do të vazhdojnë të jenë, përtej politikës dhe axhendave të cilitdo individ a lëvizje, që gjithsesi mbetet krejt i papërfillshëm përballë frymës së përgjithshme të fetarizmit islam dhe nuancës së tij tek ne!

Kjo lidhje historike që kemi me turqit, është shumë më shumë e prekshme dhe identitare, sesa me krejt vendet e tjera të botës islame, që gjithsesi kanë vendin dhe pozitën e merituar që i takon secilit në këtë marrëdhënie të shtrenjtë e të shenjtë!

Dhe, sa më shumë që afrohen këto lidhje, aq më shumë mbrohen dhe konsolidohen shtresat e padukshme që mbajnë ekuilibrat e këtij tabani identitar ndër ne!

Prandaj, ruajtja e shinave dhe mostolerimi i ndryshimit të kursit, duhen trajtuar me urtësi dhe largpamësi, duke mos shkuar pas tekave të verbra të askujt, as ambicieve të shtirakëve gjithandej, si dhe duke vënë interesin e bashkësisë së gjerë muslimane dhe atë të interesit tonë kombëtar mbi çdo interes tjetër të kujtdo qoftë dhe ushqyesit e tyre prej andej-këndej, kudo qofshin!

Hoshgjéldën..!

Shkodër, më 17 janar 2022

MYFTIU VIZITOI PRIJËSIT E KRISHTERË TË SHKODRËS

Në kuadër të vizitave dhe takimeve ndërfetare, ditën e mërkurë, më 26 janar 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, vizitoi prijësit e krishterë të komunitetit katolik dhe atij ortodoks në Shkodër.

Fillimisht, në Arqipeshkvinë Shkodër-Pult, Myftiu u prit nga Arqipeshkvi, Mons. Angjelo Massafra, me të cilin zhvilloi një bashkëbisedim të ngrohtë, duke vënë theksin tek domosdoshmëria e aktiviteteve të përbashkëta në dobi të shoqërisë dhe besimtarëve.

Myftiu dhe Arqipeshkvi ishin të mendimit se sprovat dhe sfidat me të cilat përballet njerëzimi dhe shoqëria shqiptare në veçanti, janë arsye më shumë për të bashkëpunuar e për të shtuar kontributet e përbashkëta për të mirën e shoqërisë shqiptare dhe të çdo natyre tjetër në shoqërinë tonë.

Takimet e ditës së sotme të Myftiut të Shkodrës vijnë në prag të Tre Muajve të Mirë, edhe si një kontribut i natyrshëm dhe faktik në ruajtjen dhe konsolidimin e frymës së harmonisë ndërfetare dhe vëllazërisë kombëtare.

Në takimet e zhvilluara u diskutua mbi frymën e bashkëpunimit dhe natyrën e besimeve në trajtimin e sfidave të jetës.

Të dy bashkëbiseduesit ishin dakord që komunitetet fetare duhet të bëjnë më shumë në drejtim të eliminimit të gjuhës së urrejtjes dhe ndasive për shkak të besimit dhe fesë, që përhapet në masë nëpërmjet rrjeteve sociale, si dhe distancimin nga gjuha e përçarjes për shkaqe fetare në ligjërimet politike dhe njerëzimit mbarë.

Myftiu u prit edhe nga Famullitari i Kishës Ortodokse, At Nikolla Petani, me të cilin diskutoi mbi frymën e bashkëpunimit dhe natyrën e besimeve në trajtimin e sfidave të jetës.

Dr. Selman El-Aude

"Nëse kur punon të mirën gëzohesh, dhe kur bën të keqen, hidhërohesh, atëherë ti je besimtar!

Besimtari është njeri me zemër të gjallë, e njeh të mirën dhe e mohon të keqen, por ai nuk është melek dhe as nuk është i pagabueshëm!

Ndoshta, mund ta lërë të mirën apo ta bëjë të keqen, por menjëherë e kujton Zotin e tij dhe ankohet për gjynahun e bërë!

Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

URTËSITË E SPROVAVE

Muslimani gjatë jetës së tij do të kalojë nëpër faza të ndryshme të cilat herë-herë do ta lëkundin atë ashtu siç e lëkundin stuhitë pemën. Allahu (xh.sh) thotë: Vërtetë mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë "Ne besojmë", pa u vënë në provë?![1]

Pejgamberi (a.s) në shumë hadithe na ka treguar se njeriu do të sprovohet në këtë botë. Seadi (r.a) e ka pyetur Pejgamberin (a.s): "O i Dërguari i Allahut, cilët janë njerëzit më të sprovuar?" Pejgamberi (a.s) i është përgjigjur duke thënë: "Pejgamberët, pastaj të devotshmit, pastaj ata që vijnë pas tyre, pastaj ata që vijnë pas tyre. Njeriu sprovohet sipas fesë së tij (imanit të tij), ashtu që nëse në fe është i fortë, atij i shtohet sprova, por nëse në fe është i dobët, atëherë i pakësohet sprova. (Mund të ndodhë që) Sprova vazhdon ta godasë njeriun (të ballafaqohet me të) derisa ai (një ditë) të ecë mbi tokë pa asnjë gjynah".[2]

Është pyetur njëherë imam Shafiu (rahimehullah): "Çfarë është më mirë për njeriun: t'i plotësohen dëshirat e qëllimet dhe pastaj të sprovohet, apo të sprovohet e pastaj t'i plotësohen ato?" Ai u përgjigj: "Askujt nuk mund t'i plotësohen dëshirat e qëllimet, pa u sprovuar fillimisht." Allahu i Madhëruar i sprovoi më të spikaturit ndër profetët dhe kur ata u treguan të duruar Ai u mundësoi arritjen e atyre gjërave që ata synonin e dëshironin.

Allahu i Lartësuar me urtësinë e Vet, deshi që robërit e Tij të sprovohen dhe në këtë mënyrë të përzgjidhen duke u dalluar të mirët nga të këqijtë, ata që meritojnë dashurinë dhe shpërblimet e Tij nga ata që nuk i meritojnë. Ai deshi që ata të sprovohen dhe të dallohen sikurse ndodh me floririn të cilin, kur duam ta pastrojmë e fusim në zjarr për ta shkrirë duke larguar prej tij papastërtitë[3]. Askush të mos mendojë se sprovat janë dënim prej Zotit. Ato janë ligj i Allahut (xh.sh) për besimtarët.

Urtësitë e sprovave

1. Durimi i sprovave dhe fatkeqësive për hir të Allahut është një lloj adhurimi. Allahu i Lartësuar thotë: (Në jetën e kësaj bote) Ne ju sprovojmë me të keqen e me të mirën"[4]. Kur njeriu vihet në provë me mirësi, duhet të tregohet mirënjohës ndaj Allahut ndërsa kur vihet në provë me vështirësi dhe të këqija duhet të bëjë durim. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Është e habitshme çështja e besimtarit: çdo gjë që i ndodh është në të mirën e tij. Nëse i ndodhë diçka e mirë, ai falënderon dhe kjo është e mirë për të; nëse i ndodhë diçka e keqe, ai duron dhe kjo përsëri është mirë për të. Kjo nuk mund t'i ndodhë askujt përveç besimtarit."[5]

2. Sprovat e kalisin besimtarin për t'u përballur me vështirësitë e sfidat e jetës dhe e bëjnë atë më të qëndrueshëm në fe.

3. Ne jemi robër të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi. Sprovat dhe fatkeqësitë na ndihmojnë të bindemi më shumë se jemi krijesa të Zotit se jemi nën pushtetin e Tij hyjnor se Ai vepron ndaj nesh çfarë të dëshirojë se ne nuk kemi nga t'i shmangemi vendimit dhe caktimit të Tij. Allahu (xh.sh) thotë: "Përgëzoji të duruarit të cilët, kur u bie ndonjë fatkeqësi, thonë: "Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi!"[6]

4. Sprovat dhe fatkeqësitë na shtyjnë t'i lutemi vetëm Allahut dhe t'i nënshtrohemi Atij me teube (pendim) të çiltër. Kur na bie ndonjë e keqe e ndiejmë se jemi të dobët dhe kemi nevojë për Allahun e Madhëruar.

5. Vuajtjet na shtyjnë të kemi mëshirë për njerëzit në vuajtje. Kur njeriu vuan vetë, atij i vjen keq për njerëzit që vuajnë. Pra, vuajtja prej sëmundjes apo prej diçkaje tjetër kultivon tek njeriu ndjenjën e mëshirës. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Mëshironi ata që janë në tokë, që t'u mëshirojë Ai (Allahu) që është në qiell".[7]

6. Njeriu kupton se sa pak vlerë ka kjo botë. Edhe fatkeqësia më e vogël që i bie njeriut ia prish qetësinë dhe bën që ti harrojë kënaqësitë. Allahu (xh.sh) thotë: "Jeta e kësaj botë, në krahasim me jetën e pasme është vetëm një kënaqësi e vogël dhe kalimtare."[8] Po ashtu në një ajet tjetër thuhet: "Kënaqësia e kësaj bote në krahasim me atë të botës tjetër është shumë e vogël".[9] I mençuri nuk

1. Kurani, El-Ankebut: 2.
2. Transmetuar nga Imam Ahmedi.
3. Zadul Mead, varianti në shqip, 3/21-27.
4. Kurani, El-Enbija: 35.
5. Transmetuar nga Muslimi.
6. Kurani, El-Bekare: 156.
7. Transmetuar nga Ebu Daudi dhe Tirmidhiu.
8. Kurani, Err-Rrad: 26.
9. Kurani, Et-Teube: 38.



Allahu i Lartësuar me urtësinë e Vet, deshi që robërit e Tij të sprovohen dhe në këtë mënyrë të përzgjidhen duke u dalluar të mirët nga të këqijtë, ata që meritojnë dashurinë dhe shpërblimet e Tij nga ata që nuk i meritojnë

Megjithëse sprovat kanë gjithë këto të mira për besimtarin, përsëri njeriu nuk duhet t'i dëshirojë apo t'i kërkojë ato; përkundrazi ai duhet të dëshirojë shëndet dhe të mira; ai duhet t'i lutet Allahut për shëndet e të mira dhe për ta ruajtur nga sprovat e të këqijat.

mashtrohet me kënaqësitë e pakta e të përkohshme të kësaj bote përkundrazi ai bën punë të mira në këtë botë për të gjetur shpërblimin e tyre në ahiret.

7. Nga sprova del në pah se kush janë besimtarët e vërtetë dhe kush janë dyfytyrëshit. Sprova e dallon të sinqertin nga gënjeshtari atë që kërkon xhenetin e Allahut dhe atë që kërkon kënaqësinë dhe interesin e kësaj bote.

8. Falja e gjynaheve. Muslimani gjatë jetës së tij patjetër që ka për të bërë gjynahe dhe Allahu i Madhëruar me rahmetin e Tij do që robin e Vet ta pastrojë nga ato gjynahe dhe këtë e bën nëpërmjet sprovave të ndryshme me të cilat ia falë gjynahet. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Për çdo mundim, sëmundje, pikëllim, trishtim, dhimbje, fatkeqësi, madje edhe për një gërvishtje të një gjembi që i bie muslimanit, Allahu i shlyen atij pjesë nga gjynahet e tij!."[10]

Ebu Bekri (r.a) e ka pyetur Pejgamberin (a.s), për kuptimin e ajetit: "(Shpëtimi në jetën tjetër) nuk do të jetë as sipas dëshirës suaj (o muslimanë), as sipas dëshirës së ithtarëve të Librit. Por kushdo që bën një të keqe, do të ndëshkohet për atë dhe nuk do të gjejë as mbrojtës, as mbështetës tjetër në vend të Allahut."[11]

Ebu Bekri i ka thënë: "O i Dërguari i Allahut, si do të shpëtojmë në Ditën e Gjykimit, nëse dënohemi për çdo të keqe?" A nuk sëmuresh ndonjëherë; a nuk lodhesh; a nuk mërzitesh; a nuk të zë belaja?" "Po" – ia ktheu Ebu Bekri. "Kjo është ajo me të cilën ndëshkohemi." – i tha Profeti (a.s).[12]

9. Allahu nëpërmjet sprovave e dënon besimtarin për disa gjynahe që ai ka bërë, si p.sh. ia pakëson riskun apo ia vështirëson atë për shkak të gjynaheve që ka bërë. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Njeriut mund t'i ndalohet (t'i ndërpritet) risku (furnizimi) për shkak të ndonjë gjynahu që ai ka bërë...".[13]

Megjithëse sprovat kanë gjithë këto të mira për besimtarin, përsëri njeriu nuk duhet t'i dëshirojë apo t'i kërkojë ato; përkundrazi ai duhet të dëshirojë shëndet dhe të mira; ai duhet t'i lutet Allahut për shëndet e të mira dhe për ta ruajtur nga sprovat e të këqijat. Por nëse na bien fatkeqësi, vuajtje apo sëmundje, duhet të durojmë me shpresën se do të arrijmë të mira që u përmendën më lart. Kështu na ka udhëzuar i Dërguari i Allahut.

Njëherë Pejgamberi (a.s) vizitoi një burrë të sëmurë, të cilin e kishte dobësuar shumë sëmundja. I Dërguari i Allahut i tha: "A i je lutur Allahut? A i ke kërkuar Zotit tënd të të ruajë nga sëmundjet dhe të këqijat?" Ai tha: "Kam bërë këtë lutje: "O Allah, dënimin që ke për të ma dhënë në ahiret, ma jep ta vuaj tani në këtë botë!" I Dërguari i Allahut tha: " Subhanallah (i Dëlirë është Allahu nga çdo e metë)! Ti nuk e përballon dot këtë! Ti duhet të ishe lutur kështu: "O Allah, na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit të xhehenemit". Pastaj i Dërguari i Allahut bëri lutje për të dhe Allahu e shëroi. [14]

Thuhet se një burrë nisur nga shpërblimi i madh që ka durimi i sprovës ka thënë: "O Allah, më jep çfarëdo sprovë të duash!" Allahu i dha atij një sprovë të vogël në trup: nuk bënte dot urinën. Si pasojë, ai nuk bëri dot durim. E humbi provën![15]

Kështu, nuk duhet të kërkojmë sprova, por nëse na bien ato duhet të bëjmë durim. Allahu e bën të durueshëm besimtarin që i bien sprovat pa i kërkuar ato por me kusht që ky besimtar të jetë i çiltër me Allahun (xh.sh). Pejgamberi (a.s) ka thënë: "O njerëz mos dëshironi ballafaqim me armikun por lutuni Allahut për shpëtim nga të këqijat. Nëse ndodh të ballafaqoheni me armikun atëherë bëni durim".[16]

I lutemi Allahut të Madhëruar që të na bëjë të qëndrueshëm ndaj sprovave.

10. Transmetuar nga Buhariu.
11. Kurani, En-Nisa: 123.
12. Transmetuar nga Imam Ahmedi.
13. Transmetuar nga Imam Ahmedi, Hakimi dhe Ibn Hibani.
14. Transmetuar nga Muslimi.
15. İmtihanın Hikmeti, Sejjid Kutub;Ibn Kajjim el-Xhevzijje, fq:10. Polen Yayınları. Temmuz, 2020.
16. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

H. Burhan Fili

Nëse don nji popull lehtë ta sundosh,
nji mori hallesh duhet t'i krijosh...
në punë, administratë, e trafik,
nga prangat e halleve s'ka ku me ikë.

Me ngritje çmimesh e taksa tjera,
politikani i regjur t'i len të dera...
Lene të shajë, të çirret e të shfryjë,
'dyert' ia ke dyllosë... nuk ka ku të hyjë.

Poshtë e lartë do japë e do vejë,
me vehte do të flasin si budallenjë...
Por të tillë ata nuk janë,
ama halle të mëdha kanë.

Kështu bajnë politikanët me popullin e gjorë,
në parti të ndryshme kalon dorë më dorë.
A kjo asht ajo që e quajnë liri,
e ashtuquajtura demokraci?

E me kyt bindje popujt rrapatosen,
andrrat e tyre në humnerë groposen...
Çohu o njeri ma në gjumë mos flej,
me dritën e ndërgjegjes rrugën gjej!

Mos e lejo politikanin më prrofka të gënjejë,
për jetë ma të mirë duhet të jesh i dejë.
Por nëse këtë me ngulm se kërkon,
faji asht i joti, s'ke pse ankon.

ME KONSULLIN E ARABISË SAUDITE NË ATHINË

Elmaz Fida

Shtator 1996. Ishim nisur me aeroplan për në Arabinë Saudite, pasi kishim kaluar gjashtë muaj pushime të këndshme në Shqipëri. Atë vit do të fillonim studimet në universitet. Me të mbërritur në Athinë, filluam përgatitjet për të marrë avionin e radhës drejt Xheddas. Por... punonjësi që na kontrolloi pasaportat dhe biletat na ngriu në vend. "Ju nuk keni vizë për në Arabinë Saudite. Ka një javë që u ka përfunduar, prandaj u duhet të ktheheni sërish në Tiranë."

Si? Çfarë ka ngjarë? S'ka mundësi!

Viza që kishim marrë ishte gjashtë mujore. Ne, e kishim llogaritur me muajt diellorë, sakaq viza llogaritej me muajt hënorë dhe punonjësi grek kishte të drejtë. Ne nuk kishim vizë për të udhëtuar drejt Arabisë Saudite.

"Po si i bëhet?" pyeti dikush prej nesh.

"Biletën që keni për në Xhedda, do ua kthej për në Tiranë" tha greku i vendosur.

U mblodhëm ta shqyrtojmë këtë problem që na kishte dalë. Ishim dymbëdhjetë veta të cilëve u kishte ikur fytyra fare dhe silleshin rrotull, pa ditur ç'të bënin.

Të ktheheshim në Tiranë?! Jo jo. Atje s'ka akoma ambasadë të Arabisë Saudite. Kështu, duhej ti dërgonim pasaportat në Itali për të marrë vizë. D.m.th, ishte një alternativë që do na kushtonte shumë.

Po si i bëhet?

Ta marrim ambasadën e Arabisë Saudite në telefon dhe tu tregojmë për problemin.

Mendim shumë i mirë.

Njëri prej nesh që dinte anglisht, iu afrua punonjësit grek, diku tek të dyzetat, dhe i kërkoi numrin e ambasadës.

"Për çfarë u duhet numri i ambasadës?" pyeti ai gjithë kureshtje.

"Duam t'ua qajmë hallin" i thamë

E nxori numrin si me përtesë dhe na e dha. Një bashkëvuajtësi ynë, Sedati, i telefonoi ambasadës. "Jemi një grup studentësh shqiptarë dhe aktualisht ndodhemi në Athinë. Pasi kaluam gjashtë muaj në Shqipëri, po kthehemi në universitet, por tani e kuptuam që na ka mbaruar viza, pasi e kishim llogaritur se është gjashtë muaj me kalendarin diellor. Ju lutem bëni diçka!"

Folësi matanë telefonit ishte konsulli, i cili përgjigjet:"Njëri prej jush, të marrë pasaportat, ta shkojë tek zyra e vizave greke, të kërkojë vizë dhe të niset menjëherë drejt ambasadës që është gjysmë ore larg aeroportit."

Vajti shoku ynë me pasaportat tek zyra ku jepeshin vizat dhe u tregoi hallin punonjësve grekë. Pasi e dëgjoi, greku i lëshoi një sy pasaportave që mbante shoku ynë në dorë dhe e pati të kollajtë ta kuptojë se bëhej fjalë për shqiptarë.

"Alvanos?!" pyeti ai me buzët e rrudhura.

"Yes, albanian" ia ktheu shoku dhe bashkëvuajtësi ynë.

Greku nuk ktheu përgjigje, të cilën e morëm nga lëvizja e tij e kokës në formë horizontale, që do të thoshte jo.

Iu drejtuam sërish telefonit me ambasadën e Saudisë.

"Veçse jemi shqiptarë, me të cilët greku e ka shumë ters, ne jemi studentë dhe në një universitet fetar, në Arabinë Saudite. Kështu që, është e pamundur të na japin vizë."

"Mirë prisni aty! I thoni punonjësit grek që mos ua prishë biletat! Do të vij shumë shpejt!" dhe e mbylli telefonin.

Një turmë prej 12 vetash u nis drejt grekut. Pasi na dëgjoi, me një qeshje ironike na tha:"Unë e kuptoj entuziazmin tuaj, por ... Unë ka katërmbëdhjetë vite që e kam këtë vend pune dhe nuk ka bërë vaki të vijë konsulli i një ambasade të huaj, e të japë viza këtu në aeroport!!! Aq më tepër, konsulli i Arabisë Saudite! E kuptoni çfarë po thoni?!"

"Mirë, por ti mos na i prish biletat që kemi për Xhedda!" i thamë njëzëri.

"Ok alvanos" tha ai.

Ishte ora gjashtë i mbrëmjes dhe avioni për Xhedda nisej në shtatë. Në gjashtë e gjysmë, pamë një burrë të gjatë, me pak mjekër, me syze, esmer dhe me flokë të rëna. Ai u ndalua nga një polic grek, i cili më sa duket i kërkoi kartën e identitetit. Pasi përfundoi me policin, na u drejtua neve që qëndronim si të ngrirë.

"Esselamu alejkum! Ju jeni ata studentët shqiptarë?"

Ne desh fluturuam nga gëzimi dhe e rrethuam menjëherë.

"Pasaportat shpejt" tha ai.

Menjëherë, mbi tavolinën e punonjësit grek, u radhitën dymbëdhjetë pasaporta.

Konsulli, nxori një zarf me disa vula dhe menjëherë filloi të vulosë pasaportat tona, duke na dhënë një vizë të re dy javorshe, derisa të shkonim në Arabinë Saudite.

Sakaq, punonjësi grek kishte mbështetur faqen mbi pëllëmbë dhe ndiqte procesin, duke mos u besuar syve.

Të them që ishim shumë të emocionuar, është e tepërt.

Pasi përfundoi, i thamë:"Zoti ta shpërbleftë me të mira! Si të ta shpërblejmë këtë nder që na bëre?!"

"Nuk dua asgjë prej jush, thjesht, kur të shkoni në Qabe, në Mekë, të bëni dua (lutje) për mua!" dhe na dha dorën duke u larguar.

Sa herë që kam shkuar në Mekë, nuk e kam harruar atë person në lutjet e mia. Edhe fakti që po e ndaj me ju këtë ngjarje, uroj të shërbejë si një lutje për atë njeri. Zoti ia shpërbleftë me të mirat e Tij të pafund!



ARTI I BASHKIMIT TË ZEMRAVE

Prim. Dr. Med. Sc. **Ali F. Iljazi**

Për artin e bashkimit të zemrave na ka treguar Pejgamberi, (a.s) gjatë misionit të tij profetik, si dhe ata që janë edukuar nën mbikëqyrjen e zgjuar të tij, si dhe ata që pas tyre kanë pasuar rrugën e tyre. Do t'i tregojmë disa principe të këtij arti.

1. MBIZOTËRIMI I HIDHËRIMIT

Allahu i Madhërishëm në Kuranin fisnik thotë: "...ata që frenojnë mllefin, që u falin (të keqen) njerëzve, e Allahu i do bamirësit."

Ekzistojnë tre shkallë për mbizotërimin e hidhërimit: e para, e mesme dhe shkalla e bamirësve.

Shkalla e parë, është e atij të cilit i bëhet e keqja dhe ai përmbahet dhe nuk i ekspozohet kurrfarë mos kënaqësie - "ata që e frenojnë mllefin"

Shkalla e dytë, është e atyre që bëjnë mirë "njerëzve u falin". I këtilli shkon tek ai, i cili i ka bërë keq dhe i thotë: "Allahu të faltë!".

Shkalla e tretë, është e atij i cili rritë të mirën: "Allahu i do bamirësit". I këtilli shkon në vizitë tek ai, i cili i ka bërë keq, i dërgon dhuratë dhe përshëndetet me të.

Tregohet që shërbëtori i Harun Reshidit duke sjellë ibrikun me ujë të nxehtë për të shërbyer kalifin, rrëshqiti dhe uji i vluar e përcëlloi kalifin. Haruni u zemërua, ndërsa shërbëtori ishte mendjemprehtë dhe i tha: "Ata që frenojnë mllefin." Kalifi i tha: "E mbizotërova mllefin." Shërbëtori tha: "Dhe falin njerëzit." Në këtë kalifi tha: "Të fala." Pastaj shërbëtori vazhdoi e tha: "Allahu i do bamirësit." Ndërsa kalifi tha: "Shko, je i lirë për hir të Allahut".

2. MËNJANIMI I KEQBËRJES DHE URREJTJES

Në Luftën e devesë u ballafaquan Aisha (r.a) Talha, Zubejri dhe sahabët e tjerë (r.a) në një tabor, me Aliun (r.a) dhe disa sahab, pjesëmarrës të Bedrit në taborin tjetër. Kur Talha (r.a) u vra gjatë luftës, edhe pse ishte në taborin kundër të Aliut (r.a), imam Aliu zbriti nga kali i tij, e futi shpatën në këllëf, u gjunjëzua para Talhës, e shikoi dhe i tha: "Më vjen rëndë, Ebu Muhammed, të shohë në këtë gjendje, por i lutem Allahut të na bëjë prej atyre për të cilët i Lartësuari thotë: "Ne kemi hequr prej zemrave të tyre çfarëdo urrejtje, e ata në mbështetësi qëndrojnë ballë për ballë njëri tjetrit duke qenë të vëllazëruar."

Shikoni këtë shembull të bukur, këtë pastërti, ata ishin në betejë por pa marrë parasysh këtë Aliu (r.a) e shtrëngon në përqafim Talhën (r.a) dhe e kujton që me të do të hyjnë në xhenet. Ky shembull tregon që sahabët prapëseprapë kanë qenë njerëz, jo melek, por ishin shembulli më i mirë për njerëzimin.

3. SAKRIFICA E FAMËS DHE PASURISË NË RRUGËN E ALLAHUT

Ebu Damadam falej natën e pastaj i lutej Allahut: "O Zoti im, unë nuk kam pasuri që ta ndajë në rrugën Tënde, as trup për të luftuar për Ty, por do ta ndaj krenarin time, të cilën e kanë përçmuar myslimanët e tjerë. O Zoti im, ai i cili më ka sharë ose më ka fyer, ose më ka bërë padrejtësi, ose më ka përgjuar, bëja (kefaret) shpagim!"

Transmetohet që një ditë Pejgamberi (a.s) i nxiste sahabët në dhënien e lëmoshës dhe u ngrit Utbe bin Zejd duke thënë: "O i Dërguar i Allahut, po na nxitë në dhënien e lëmoshës, ndërsa unë nuk kam asgjë përveç krenarisë sime, dhe ia ndaj atij që më ka bërë padrejtësi." Ditën tjetër erdhi Pejgamberi (a.s) dhe tha: "Ku është Utbe bin Zejd, dhënësi i krenarisë së tij, Allahu e pranoi nga ai."

4. PËRBALLIMI I GABIMEVE TË TJERËVE

Shënohet se tek Hasani Basriu erdhi një njeri dhe i tha: "O Ebu Seid, filan person të ka përgojuar." Hasani ia dha një enë me hurma duke i thënë: "Shko e thuaj, m'i ke dhuruar veprat e tua të mira, e unë po të dhuroj për këtë enë me hurma!"

Transmetohet që Musai (a.s) ka thënë: "O Zoti im më prano diçka!" Allahu i tha: "E çfarë është kjo, o Musa?", ndërsa Ai më së miri e di çfarë është ajo. Musai i tha: "Të lutem o Zot, të më ruash nga gjuhët e njerëzve." Në këtë Allahu i tha: "O Musa, betohem në krenarinë dhe lartmadhërinë Time, Unë Vetit nuk ia kam bërë këtë cilësi, Unë i krijoj, i furnizoj e ata më shajnë!"

Pra, njeriu kjo qenie e dobët, e mjerë, e përbuzur e shanë Allahun?! Qoftë i lavdëruar i Lartmadhërishmi, Një i Cili nuk ka lind askënd as nuk ka lind nga askush, dhe asgjë nuk është i barabartë me Atë.

Buhariu transmeton nga Ebu Hurejre (r.a), që Pejgamberi, (a.s) ka thënë: "Ka thënë Allahu i Madhërishëm: 'Më shanë i biri i Ademit, e kjo nuk i përshtatet me më sharë, më futë në gënjeshtër, e kjo nuk i përshtatet! Sa i përket sharjes, janë fjalët e tij që unë kam djalë, e sa i përket futjes në gënjeshtër, janë fjalët e tij - nuk do të më Krijoj përsëri siç më ka krijuar herën e parë.'"

5. VETËLLOGARITJA

Erdhi një njeri në Qabe, dhe filloi të kritikonte Ibn Abbasin (r.a) para njerëzve, ndërsa ai ulte kokën. Ai vazhdoi edhe më tej të kritikonte njeriun, i cili ishte dijetar i shquar i kohës, ndërsa Ibn Abbasi duke ngritur kokën i tha: "A po më shanë, përderisa unë i kam tre cilësi të bukura?" Njeriu e pyeti: "Cilat cilësi të bukura i ke?" Ibn Abbasi u përgjigj: "Betohem në Allahun se nuk bie (zbret) shi në Tokë e unë të mos gëzohem dhe të falënderoj Allahun për këtë, edhe pse vet nuk kam as ara, as livadhe, as deve e as dele." Njeriu përsëri e pyeti: "Po cilësia e dytë e bukur që ke?" Ibn Abbasi i tha: "Nuk dëgjoj për asnjë gjykatës të drejtë, e që të mos lutem për të tek Allahu në mos prezencën e tij, edhe pse nuk kam tek ai akt padie." Njeriu vazhdon të pyet: "Po e treta cilësi e bukur?" Ibn Abbasi i tha: "Nuk e kam kuptuar asnjë verset nga Libri i Allahut, e që nuk kam dëshiruar që myslimanët ta kuptojnë si unë".

Këto janë disa nga cilësitë që kanë poseduar sahabët që u edukuan në kohën e Pejgamberit (a.s) dhe atyre që pasuan ata. Ata ishin mjeshtër të artit të bashkimit të zemrave të njerëzve. Bekimi dhe mëshira e Allahut qoftë mbi Pejgamberin (a.s), shokët e tij dhe gjithë ata që i pasojnë këta deri në Ditën e Gjykimit, e neve na bëftë prej atyre që bashkojnë zemrat e besimtarëve.

Evans Drishti

TELEFONATA E ORËS 04

S'të zinte gjumi atë natë, e s'kishte si të të zinte natyrshëm...

Një ndjesi e thellë të mbërthente shpirtin e rraskapitur nga malli...

Mendja s'e linte syrin të shihte asgjë përreth, pasi preokupohej vetëm me momentin dhe drithërimat shpirtërore që do sillte ora 04'

As buka s'të shkonte atë natë, teksa mendoje se ç'bisedë do bëhej në atë minutazh të shkurtër telefonik...

Kishin kaluar kohë pa komunikuar me "gjakun" që rridhte atje tutje, shumë përtej, matanë oqeanit...

Shumë gjëra dëshironte zemra të fliste, por mendja "karikonte" minutazhin...

Si të formulohej ajo "e shkretë" fraze apo edhe fjalie, që mezi priste të përçonte një ndjesi malli diku përtej, drejt një zemre që s'kuptohej si rrihte për shkak të largësisë dhe mungesës së një pamjeje "misterioze"...

Ngriheshin me "rrëmbim"in që sillte stresi i momentit dhe merrnin udhën drejt "postës" ku priste "centrali" dhe ndërkohë që merrej "aksesori" i telefonit, dora seç pësonte një "drithërimë" emocionuese" që rënqethte tërë shpirtin e evakuar.

S'kuptohej "minuti" si kalonte, e ndërkohë mjaftohej gjithçka vetëm me një "dëgjim" të zërit që vinte nga "përtej"... Një mendje "e përgjumur" që vërtitej dhe qante si me dënesë për të kuptuar "zërin e ngrohtë" dhe "mallëngjyes" të njeriut të dashur që priste përtej "kufirit" ...

I gëzoheshin frazës "Mirë jemi!", e cila këtë herë mbarte një tjetër peshë "mbreslënëse"... Dhe ajo frazë përcillej e përcillej me ditë të tëra... muaj... pse jo dhe vite... Një "botë e mbyllur" kishte patur fatin të "kryente" një "bisedë telefonike" me një "botë të jashtme" sa për të dëgjuar "një zë"...

"30", "50", "100" impulse...

Të tilla ishin kartat e asokohe, që ofroheshin për kryerjen e një "telefonate" që s'zgjaste më shumë se "2 minuta", por që në të vërtetë të dukeshin si "dy orë"...

S'ekzistonin celularët në atë kohë, e ndërkaq ishte një "luks" i madh të disponoje një "aksesor" brënda në shtëpi. Të paktë ishin familjet që kishin "numra fiks" në shtëpitë e tyre. E ndërkaq ishte edhe "fati i tyre" të prisnin e të përcillnin miqtë e afërt apo të largët që do të "kryenin" një telefonatë me të dashurin e tyre të zemrës.

Karta "30" apo "50" impulsesh merrej sa për të telefonuar "komshiun" apo "të afërmin" që dispononte telefonin, që ti njoftonte familjarët se të nesërmen në një "x orë" priteshin" për një telefonatë.

Ç'kënaqësi!...

Ç'mbresa të pashlyeshme!...

Të nesërmen familjarët vraponin me të shpejtë në "orarin e shumëpritur" drejt shtëpisë së "komshiut fatlumë", trokisnin "të ndrojtur" për shqetësimin që po u sillnin, kërkonin "ndjesë" apo "hallallëk" si një "shlyerje" e "dëmit" të shkaktuar, madje në shumë raste s'mungonin as "dhuratat" simbolike" si në këmbim të "nderit" që u bëhej...

Me t'u dëgjuar "zilja e shumëpritur" e telefonit, zemrat rrihinin fort, e ndërkohë sytë dridheshin se "kërkonin" të përloteshin, por ja që në shtëpinë e komshiut sikur s'shkonte "përlotja"...

E ç'të flisje në atë telefonatë!?...

Emëruesi i përbashkët i besadës ishte vetëm fjala "Mirë!" edhe pse natyrshëm asgjë s'ishte për "MIRË!...

Whatsap'i i bekuar...

Ja dhe koha e internetit!...

Ja dhe koha e lumturisë masive!...

S'është nevoja të mbash "stress" për të "shuar" një "mall", pasi pikërisht sot nuk ka ngelur më "MALL!"

S'është nevoja të ngelësh zgjuar tërë natën në pritje të "orës 04'" për të kryer "telefonatën e ëndrrës!...

S'është nevoja të trokasësh tek "komshiu" fatlum i telefonit fiks!...

Madje s'është nevoja tashmë të kesh as një "telefon fiks"!...

Teknologjia me zhvillimet e saj marramendëse hoqi tashmë "distancat" e pamatshme duke i afruar njerëzit jo vetëm nga "zëri", por edhe nga pamja"

Por... Kujdes!...

Teknologjia po heq edhe "privatësinë" si një mbështetëse dhe mburojë e "identitetit".

Nuk mjaftohen familjarët tashmë të "marrin vesh" si janë fëmijët apo të afërmit e tyre, por interesimi kalon çdo kufi të privatësisë.

Nëpërmjet "fotove", "videove" apo telefonatave me pamje familjarët informohen për shumë e shumë detaje,

të rëndësishme apo të parëndësishme, të vlefshme apo të pavlefshme...

Megjithatë "kurioziteti" nuk shuhet asnjëherë...

Ajo çfarë duhet të përfitohet nga "ky zhvillim" i teknologjisë është "të kuptuarit" se ekziston një "tjetër" botë, përveç asaj që të rrethon përditshmërinë dhe një "tjetër" botëkuptim për veten, tjetrin dhe jetën në përgjithësi.

Prandaj mbetet "domosdoshmëri" dhe "kusht" të kuptojmë se ajo që duhet ndryshuar në të mirën e zhvillimit tonë është "mendësia" dhe "mentaliteti" për të përfituar sa më shumë nga lehtësimet që ofron "realiteti jetësor"

Prandaj;

Ju prindër!...

Duajini fëmijët me natyrën dhe kompleksitetet e tyre, me vizionet dhe botëkuptimet përkatëse që të kuptoni sa të rritur janë...

Kuptojini fëmijët dhe botën e tyre, pavarësisht moshës që kanë, sepse çdo ide apo gjykim që sjellin përbën një degëzim të rrugëtimit tuaj...

Besojini dhe mos krijoni marrëdhënie "varësie" me idenë se kanë nevojën tuaj për çdo hap që hedhin, krijojuni mundësinë që fëmija të ecë vetë në hapat e jetës...

Mos harroni, të dashur prindër, se nuk ka kaluar për ju koha dhe mosha e leximit, që të kuptoni procesin e rritjes dhe zhvillimit të fëmijës suaj...

Ju të rinj!...

Tregohuni të ndërgjegjshëm me jetën tuaj dhe krijoni "pavarësinë" që ju duhet.

Jo çdo veprim në përditshmërinë tuaj është i nevojshëm "t'u rrëfehet" familjarëve" pasi çdo individ ka dhe duhet të ketë "identitetin" e tij "të paprekshëm"...

Besojini vetes dhe këmbëngulni të zhvilloni intelektualitetin tuaj që padyshim nis në një rrugë pa mbarim me "leximin" dhe "zhvillimin moral"...

Kërkoni të zbuloni sa më shumë për botën dhe zhvillimin tuaj intelektual, duke mos e kufizuar veten vetëm në kufijtë e "telefonit" e në veçanti duke përjetuar "stresin e kobshëm" se u duhet t'u ktheni përgjigje disa qindra mesazheve të ardhura në adresën tuaj.

Mos ia lejoni vetes të keni dy ditë të njëllojta, pasi fuqia juaj e kapërcen "njëtrajtshmërinë"...

BANESA SHKODRANE E FAMILJES LLUJA

Një ndër banesat më të vjetra karakteristike në qytetin e Shkodrës, e shpallur monument kulture kategoria I (1973), me vjetërsi rreth 280-300 vjeçare. Ajo mbart vlera arkitektonike e historike të fund shek XIX, e shtirë në një sipërfaqe prej 2160 m2 e rrethuar me mure të larta guri prej 3 (metra), kopësht, me portë të madhe hyrëse me dy kapakë e dritare karakteristike prej druri. Në oborrin e shtëpisë kanë qenë 1 kullë 2-katëshe për kuajt e bagëtitë, dyqani e furra (dhe 1 mulli uji) dhe dy puse uji me truma.

Banesa e Llujejve, është ndërtuar bazuar në stilin oriental, me punime druri e hekuri dhe guri me eksponata muzeale me merita historike.

Tavani i banesës (tetëkendor i brendashkruar katërkendorit, me cepat trekëndor të punuar herë me



gdhendje e herë i pikturuar, dhe me rozetë qendrore rrethore, e daltuar me motive floreale) ka një veçanti teknike: copë e pikturuar, dhe e ngjitur më vonë në gjithë sipërfaqen e tavanit, pikturë kavaleti.

Motivet janë gjeometrike të qendërzuara tek rozeta, ndërsa gjithë sipërfaqja, është e dekoruar me ornamente floreale.

Ndërsa pikturat murale parietale, janë të punuara "a secco" dhe si zakonisht zhvillohen mbi sergjitë, nga ana e hyrjes në Odë, 5 kamare të dekoruara me shije. Skenat e pikturuara janë 4 peisazhe të tematikave të ndryshme,që nga zhvillimi industrial e naval, e gjer tek objekti i kultit (xhami).

Familje ishte e këmbur ekonomikisht pasi zotëronte dyqane, mullinj uji e bloje, kulla sane, sipërfaqe të konsiderueshme tokash bujqësore, livadhe, kullota, pyje.

Z.Hamit Lluja lindi në vitin 1919 dhe kishte aktivitet të pasur tregtar në fushën e parfumerisë dhe kinkalerisë në Parrucë. Ai kishte 4 fëmijë, Feritin, Ferdin, Hadinë, dhe Lavdijen. Hadija, ka qënë drejtuesi i emisionit të parë fetar në Radio Shkodra. Familja është e njohur në fushën e tregtisë që në vitin 1705, dhe ruan dokumente të shumtë, çeqe bankare, monedha, kontrata, akt-marrëveshje, me status të firmës "VLLAZEN LLUJA", me aktivitet në qytetin e Shkodrës.

Bazuar në dokumente familja merrej me tregti drithërash, lëkure, prodhime cigaresh, tregti manifaturë kinkaleri parfumeri, brenda vendit dhe jashtë, në Mal të Zi, Serbi, Turqi, Itali dhe Mesdhe. Në banesën e Llujejve, janë mbajtur mbledhje e takime në momentet kritike për fatin e atdheut. Kjo familje ka dhenë ndihmesën e duhur në të gjithë drejtimet, organizative, administrative, financiare, politike dhe ushtarake.

Në këtë banesë e cila mbart mbi themele dallueshmërinë arkitekturore, gjendjen e mirë ekonomike, vjetërsinë dhe historinë e kohës si dhe pjesën e historisë së familjes, lagjes Dudas - Ndocej, Shkodrës.

(DRTK Shkodër)

GUINEA
OSE REPUBLIKA E GUINEAS

Guinea, e njohur zyrtarisht si Republika e Guinesë, është një shtet i Afrikës perëndimore, që shtrihet në bregun e Atlantikut. Guinea kufizohet nga Senegali në veri, Mali në verilindje, Bregu i Fildishtë në juglindje, Liberia dhe Sierra Leone në jug, Guinea-Bissau në veriperëndim, dhe Oqeani Atlantik në perëndim.

Guinea ka një sipërfaqe prej 245.857 km2, dhe një popullsi prej 13.702.113 banorësh (sipas Worldometers.info, janar, 2022).

Kryeqyteti i vendit është **Konakri**.

Guinea është e ndarë në katër rajone kryesore: Guinea Detare, e njohur gjithashtu si Guinea e Ulët ose ultësira Basse-Coté, e populluar kryesisht nga grupi etnik Susu; rajoni malor Futa Dxhalun, që është një rajon më i freskët, dhe që shtrihet afërsisht në drejtimin veri – jug, përmes territorit të vendit, dhe populluar kryesisht nga etnia Fula; rajoni Sahelian – Guinea e Epërme, në verilindje të vendit, e populluar nga grupi etnik Malinke; dhe rajoni i xhunglës pyjore, në juglindje, që është i populluar nga disa grupe të ndryshme etnike.

Malet e Guinesë janë vendi nga ku burojnë lumenjtë e mëdhenj Niger, Gambia dhe Senegal, por edhe lumenj të tjerë të shumtë që rrjedhin në anën perëndimore të vargmalit, dhe vazhdojnë për në Sierra Leone dhe në Bregun e Fildishtë. Pika më e lartë në Guinea gjendet në malin Nimba, dhe arrin në 1752 m mbi nivelin e detit.

KLIMA

Klima në Guinea, në përgjithësi është tropikale, me dy stinë të alternuara: një sezon të thatë (nëntor deri në mars), dhe një sezon të lagësht (prill deri në tetor). Por, nëse e shohim për çdo rajon, mund të thuhet se në Guinenë Bregdetare klima është tropikale, në Guinenë Pyjore është gjysmë tropikale, Guinea e Epërme ka klimë sudaneze, dhe në Guinenë Qendrore ka klimë malore të Futa-s.

GJUHA

Gjuha zyrtare e Guinesë është frëngjishtja.

Katër rajonet kryesore gjeografike korrespondojnë me zonat e banuara nga grupet kryesore gjuhësore. Në Guinenë e Ulët gjuha kryesore është ajo Susu. Në Futa Dxhalun gjuha kryesore është Pular (një dialekt i Fulës, gjuha e etnisë Fulani). Ndërsa në Guinenë e Epërme, gjuha Malinke (Maninkakan) është më e përhapura. Rajoni Pyjor, nga lindja në perëndim, përfshin zonat gjuhësore Kpelle (Guerzé), Loma (Toma) dhe Kisi.

FEJA

Rreth 85 % e popullsisë së Guinesë janë muslimanë, 8 % të krishterë, dhe 7 % të besimeve fetare indigjene.

Pjesa më e madhe e muslimanëve në Guine i përkasin Islamit Sunit, shkollës së Imam Malikut.

EKONOMIA

Ekonomia e Guinesë varet kryesisht nga bujqësia dhe aktivitetet e tjera rurale. Guinea është mjaft e pasur me minerale të çmuara, duke poseduar një të katërtën e rezervave botërore të boksitit, më shumë se 1.8 miliardë ton mineral hekuri të cilësisë së lartë, depozita të konsiderueshme diamanti dhe ari, dhe sasi të papërcaktuara të uraniumit.

Guinea gjithashtu ka potencial të konsiderueshëm për rritje në sektorët e bujqësisë dhe të peshkimit. Toka, uji dhe kushtet klimatike atje, ofrojnë mundësi për bujqësi dhe agro-industri, në shkallë të gjerë. Dërgesat e parave nga guineasit që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, dhe eksportet e kafesë, përbëjnë pjesën tjetër të industrisë së shkëmbimeve valutore të Guinesë.

HISTORI

Ajo që sot është Guinea, dikur ishte një periferi e perandorive të mëdha të Afrikës Perëndimore. Perandoria e Ganës, që ishte nga më të hershmet e tyre, u zhvillua nëpërmjet tregtisë, por pas sulmeve të përsëritura të Almoravidëve, ajo perandori u rrëzua. Pikërisht në këtë periudhë, në rajon mbërriti për herë të parë Islami, me anë të tregtarëve afrikano-veriorë.

Perandoria Sosso (shek. 12-13) lulëzoi për një periudhë të shkurtër, dhe Perandoria e Malit erdhi në ngritje kur Soundiata Këïta e mundi sundimtarin Sosso, Sumanguru Kanté, në Betejën e Kirinës (viti 1235). Perandoria Mali drejtohej nga Mansa-t (kështu quheshin perandorët e saj), nga të cilët më i shquari ishte Kanku Mussa, i cili bëri një Haxh të famshëm në Mekë, në vitin 1324. Pas një periudhe të shkurtër pas mbretërimit të tij, perandoria Mali filloi të bjerë, dhe përfundimisht u zëvendësua nga shtetet e saj vasalë, në shekullin e 15-të, ku më të suksesshmit e tyre ishte perandoria Songhai, e cila zgjeroi pushtetin e saj rreth vitit 1460, dhe përfundimisht e kaloi Perandorinë Mali si në territor ashtu edhe në pasuri. Ajo vazhdoi të lulëzonte derisa një luftë civile, për pushtet, pasoi vdekjen e Askia Daud, në vitin 1582, gjë e cila ndikoi në dobësimin e saj. Perandoria e dobësuar ra në duart e pushtuesve nga Maroku, në Betejën e Tondibit, vetëm tre vjet më vonë. Megjithatë, marokenët rezultuan të paaftë për të sunduar mbretërinë në mënyrë efektive, dhe më pas ajo u nda në shumë mbretëri të vogla.

Pas rënies së perandorive të mëdha të Afrikës Perëndimore, në atë që sot është Guinea ekzistuan mbretëri të ndryshme. Myslimanët Fulani migruan në Futa Dxhalun, në Guinenë Qendrore, dhe krijuan atje një shtet Islam (1727 – 1896), me një kushtetutë të shkruar dhe me sundimtarë alternativë.

Samori Turé ishte themeluesi i Perandorisë Wassulu, një shtet Islam në Guinenë e sotme, dhe i vendosur në rajonin ku mbizotëronte etnia Malinké, atje që tani është Guinea e Epërme dhe Mali jugperëndimor (Wassulu). Kjo perandori i rezistoi sundimit kolonial francez në Afrikën Perëndimore, nga viti 1882 e deri në kapjen e Ture-së, në vitin 1898.

Periudha koloniale e Guinesë filloi me depërtimin ushtarak francez në zonë, në mesin e shekullit të 19-të. Dominimi francez u sigurua nga disfata në vitin 1898 e ushtrive të Samori Turé, gjë e cila i dha Francës kontrollin mbi atë rajon që sot është Guinea, edhe të zonave ngjitur. Nën francezët, vendi formoi Territorin e Guinesë, brenda Afrikës Perëndimore Franceze, dhe administrohej nga një guvernator që zakonisht ishte rezident në Dakar.

Në vitin 1958, Republika e Katërt Franceze u rrëzua për shkak të paqëndrueshmërisë politike dhe dështimeve të saj në trajtimin e kolonive, veçanërisht Indokinës dhe Algjerisë. Themelimi i një Republike të Pestë u mbështet nga populli francez, ndërsa presidenti francez Charles de Gaulle e bëri të qartë, më 8 Gusht 1958, se kolonive franceze do t'u jepej një zgjedhje e prerë mes 'më shumë autonomi në një komunitet të ri francez' ose 'pavarësisë së menjëhershme' me referendum, që do të mbahej më 28 shtator të vitit 1958. Kolonitë e tjera zgjodhën alternativën e parë, por Guinea – nën udhëheqjen e Ahmed Séku Turé, partia e të cilit (Partia Demokratike e Guinesë - Tubimi Demokratik Afrikan -PDG) kishte fituar 56 nga 60 vendet në zgjedhjet territoriale të vitit 1957, votoi me shumicë dërrmuese për pavarësinë e vendit. Francezët u tërhoqën shpejt që aty, dhe me 2 Tetor të vitit 1958, Guinea e shpalli veten një republikë sovrane dhe të pavarur, me Séku Turé si president.

Xhamia e Madhe në Konakri

SI ERDHI ISLAMI NË GUINEA

Islami në Guinea erdhi pothuajse në të njëjtën mënyrë siç erdhi në gjithë Afrikën Perëndimore, kryesisht nëpërmjet tregtarëve myslimanë të cilët mbërritën në vend, qoftë nga Gadishulli Arabik ose nga vendet e Magribit Arab. Tregtarët e fisit Fula luajtën një rol të rëndësishëm për përhapjen e Islamit në dy rajone, në atë të Nigerit të Epërm dhe të Senegalit, veçanërisht pasi ata u vendosën në zonën e Futa Dxhalun (Ginea Qendrore). E njëjta gjë mund të thuhet edhe për fiset Mandxhu dhe Susu, të cilët u përpoqën shumë për përhapjen e Islamit dhe të mësimeve të tij.

Përvoja e myslimanëve të Guinesë ishte shumë mbresëlënëse. Muslimanët e atij vendi dhanë gjithë ç'kishin vetëm për të përhapur Islamin. Ata u përpoqën në rrugën e Zotit, me sinqeritet dhe vendosmëri... Ata punuan fort për të mësuar Sheriatin dhe gjuhën arabe, dhe shkruan libra të dobishëm në këtë fushë.

Gjithashtu, studentët që u dërguan në universitetet Islame, ku në krye të tyre qëndronte Universiteti i Az'harit Sheríf, luajtën gjithashtu një rol të madh në zhvillimin e ndërgjegjësimit të myslimanëve të Guinesë. Pas kthimit të tyre nga nga vendet ku studjuan dhe mësuan Islamin, ata studentë krijuan shoqata dhe institucione për vazhdimin e veprimtarisë së Thirrjes Islame, derisa këto institucione u përhapën në të gjitha pjesët e Guinesë dhe ndikuan pozitivisht në ndërgjegjësimin e myslimanëve atje, për njohjen dhe rëndësinë e zbatimit të Sheriatit Islami – Legjislacionin Islam, në vendet e tyre.

Kryeqyteti, **Konakri**

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

https://almoslim.net/node/103690
https://en.wikipedia.org
https://ar.wikipedia.org
https://www.britannica.com

Dr. Mustafa Mahmud

SHPIRTI

Trupin e përshkojnë gjendje të ndryshme, nga shëndeti në sëmundje, prej shëndoshjes në dobësim, prej gjendjes energjike në zbehje, prej aktivizmit në dembelizëm, prej gjumit në zgjim, prej urisë në ngopje. Kësaj natyre trupore i bashkëngjitet një shirit ndërveprimesh, ndjenjash, instinktesh dhe fobishë, që nuk ndalen asnjëherë nga qarkullimi në tru.

Miku im doktor foli sërish, ndërkohë që ai e di se këtë herë paqartësia (problematika) do të jetë e vështirë.

Cili është argumenti yt, se njeriu ka shpirt dhe se ai do të ringjallet pas vdekjes, e se ai nuk është thjesht trup, i cili përfundon në tokë? Çfarë thotë feja jua për prezencën (thirrjen) e shpirtrave?

Pasi u mendova pak, i thashë:

Nuk ka dyshim se pyetja sot është e vështirë dhe të folurit rreth shpirtit është si të thuash në tym, ku të vërtetat ekzistuese janë të pakta, por megjithatë ato janë në anën tonë dhe jo në anën tuaj.

Edhe një herë u thellova në mendime për një farë kohe, pastaj i thashë:

Mendo me mua pak. Shenja e parë, e cila na ndihmon për t'u argumentuar për ekzistencën e shpirtit është, se njeriu ka natyrë të dyfishtë.

Njeriu ka dy natyra:

Natyra e jashtme, e dukshme, dëshmuese, e ajo është trupi, që përshkruhet me të gjitha cilësitë materialiste. Ajo (natyra e jashtme) pranon peshën, masën, është e kufizuar në vend dhe në kohë, gjithmonë e ndryshueshme, e lëvizshme dhe kalon nga një gjendje në tjetrën, nga një moment në tjetrin.

Trupin e përshkojnë gjendje të ndryshme, nga shëndeti në sëmundje, prej shëndoshjes në dobësim, prej gjendjes energjike në zbehje, prej aktivizmit në dembelizëm, prej gjumit në zgjim, prej urisë në ngopje. Kësaj natyre trupore i bashkëngjitet një shirit ndërveprimesh, ndjenjash, instinktesh dhe fobishë, që nuk ndalen asnjëherë nga qarkullimi në tru.

Për arsye se gjithë kjo natyrë dhe ndërveprimet e bashkëngjitura me të, ai përshkruhet me tiparet e lëndës dhe themi, se trupi i njeriut dhe qenia e tij shtazore, të dyja këto janë prej lëndës.

Por, ekziston edhe një natyrë tjetër, plotësisht e kundërt me të parën dhe e ndryshme nga ajo në brendësi të njeriut.

Natyrë e llojit tjetër, që karakterizohet me qetësi (heshtje), pa kohë, pa vend, e përhershme.., ajo është mendja me kriteret e saj, analogjitë, thëniet (citatet).., ndërgjegjja me ligjet e saj, ndjenja e të bukurës (estetikes) dhe "uni", i cili mbart të gjitha këto cilësi: "mendje, ndërgjegje, ndjenjë estetike dhe ndjenë morale".

"Uni" është plotësisht ndryshe nga trupi, ndryshe prej qenies shtazore, e cila irritohet prej urisë dhe erotizmit.

"Unë"-i është qenia e thellë absolute dhe përmes kësaj "vetveteje", ekzistence, individi dhe prezence në botë... Ai është këtu dhe ka qenë gjithmonë këtu..! Ai është ndjenjë e qëndrueshme dhe e shtrirë, që nuk e prek ndryshimi (kalimi nga një gjendje në tjetrën), nuk shëndoshet, nuk dobësohet, nuk sëmuret dhe nuk varet nga koha. Nuk ka të shkuar, nuk ka të tashme dhe në të nuk ka të ardhme. Ai është "çast" i vazhdueshëm që nuk shkon (nuk tretet, nuk largohet) siç shkon e kaluara. Ai personifikohet në ndjenja të vazhdueshme, të përhershme.

Këtu kemi një lloj tjetër të ekzistencës, që nuk përshkruhet me cilësitë e lëndës, që nuk e prek ndryshimi, që nuk kufizohet me vend apo me kohë dhe as që pranon peshë dhe përmasa. Madje, e kundërta, shohim se kjo ekzistencë është e qëndrueshmja, me të cilën masim të ndryshueshmet dhe, absolutja, përmes të cilës njohim të gjithë atë, që është relative në botën lëndore.

Gjëja më e saktë, me të cilën mund ta përshkruajmë këtë ekzistencë është shpirtërore dhe se natyra e tij është shpirtërore.

Tani, kemi të drejtë të pyesim: Cila prej këtyre dy natyrave është me të vërtetë njeriu?

A, është njeriu në të vërtetën e tij, ky trup apo shpirti i tij?

Për të njohur përgjigjen, ne duhet të kërkojmë, se cila prej dy natyrave është sunduese ndaj tjetrës.

Materialistët na thonë, se njeriu është trupi i tij dhe se trupi, ai është sunduesi, e gjithçka që është përmendur, prej mendjes, logjikës, ndjenjës estetike, ndjenjës etike dhe ndërgjegjes dhe se ky "mitizëm", i cili quhet "vetvetja" apo "uni", të gjitha këto e pasojnë trupin, janë dytësore ndaj tij dhe ndjekëse të tij, marrin urdhra prej tij, i kryejnë shërbime atij dhe ai merr përsipër ngopjen e epshit dhe dëshirave të tij.

Kjo është thënia e vëllezërve tanë materialistë dhe kjo është gabim. E vërteta është, se trupi është ndjekës dhe jo i ndjekur, i urdhëruar dhe jo urdhërues; për të mos u uritur trupi, ne refuzojmë ta furnizojmë me ushqim, sepse ne kemi vendosur të agjërojmë këtë ditë për hir të Allahut dhe të mos nxitet prej asnjë epshi, ne e kundërshtojmë atë!?

A,nuk zgjohemi në mëngjes dhe trupi automatikisht fillon të zbatojë planin e punës të vendosur nga mendja dhe i ka grupuar pikat e tij, pikë për pikë.., nga kjo orë deri në këtë orë? Tash, mendo pak, kush është këtu ndjekësi (pasuesi) dhe i ndjekuri (i pasuari)?

Në momentin e vetëflijimit, kur flijuesi vendos në trup rripin e dinamitit dhe shkon përpara për të shpërthyer tankun dhe këdo që është në të, ku është trupi i tij këtu? Ku është interesi lëndor, të cilin e arrin me vdekjen e tij? Kush e urdhëron tjetrin? Shpirti ka vendosur ekzekutimin e trupit në një moment plotësisht ideal, që nuk mund ta shpjegojë asnjë shkollë lëndore, me asnjë fitim material dhe trupi nuk mundet t'i rezistojë këtij urdhri, e as që zotëron asnjë fuqi të përballet me të; nuk zotëron, veçse të tretet plotësisht. Këtu shfaqet, se cila prej dy ekzistencave është më e lartë dhe cila prej dy natyrave është njeriu i vërtetë?

Ne, sot, kemi më shumë se një argument, se trupi është ekzistenca dytësore..! P.sh., ajo që po ndodh tani prej ndodhive të prerjes, zëvendësimit dhe mbledhjes së organeve, çfarë po lexojmë për zemrën elektronike, veshkat artificiale, bankën e gjakut, bankën e syve dhe depot e aksesorëve njerëzorë, ku bëhet vendosje e këmbëve, krahëve dhe zemrës.

Ndoshta nuk mund të jetë gazmore (barcoletë), që në vitin 2050 dhëndri të hyjë në dhomën e nuses së tij dhe ta gjejë atë duke hequr dhëmbët e vënë, paruket, gjoksin prej silikoni, syrin artificial dhe këmbët prej drurit, e të mos mbesë prej saj, vetëm se skeleti, sikur shasia e makinës, pasi i ke hequr tapicerinë, sediljet dhe llamarinat.

Deri në këtë gradë arrin zbërthimi (çmontimi) i trupit, montimi dhe zëvendësimi i tij, pa i ndodhur gjë personalitetit, sepse këto krahë, këto këmbë apo këto flokë, sy, gjoks, të gjitha këto gjëra nuk janë njeriu!

Edhe asaj (makinës); ajo transporton, i ndërrohen pjesët, i vendoset bateria, vida, pjesë të ndryshme alumini, pa i ndodhur gjë! Njeriu, nuk është pjesët e trupit të tij, por shpirti që rri në timonin e drejtimit për të menaxhuar këtë makinë, që quhet trup.

Ajo që ndodh me vdekjen është, se natyra e tretshme bashkohet me të tretshmen dhe natyra e përjetshme bashkohet me përjetësimin, kështu që trupi shkon (bashkohet) me dheun, ndërsa shpirti me botën e përjetshme.

Ai është zyra, të cilën e përfaqëson këshilli drejtues prej qelizave të trurit, por ai nuk është truri.

Truri, shembulli i tij është sikur shembulli i qelizave të trupit, që i binden urdhrave, të cilat i jepen dhe i shpreh ato, por ai në fund të fundit nuk është më shumë, se sa një dorashkë për të..! Dorashkë, të cilën e vesh kjo dorë e fshehtë, e cila quhet shpirt dhe përmes tij sillet (vepron) në botën lëndore.

Prej gjithë këtyre shembujve kuptojmë, se njeri ka dy natyra:

Natyra esenciale (thelbësore) sunduese (qeverisëse), që është shpirti.

Dhe, natyra dytësore, e tretshme, që është trupi.

Ajo që ndodh me vdekjen është, se natyra e tretshme bashkohet me të tretshmen dhe natyra e përjetshme bashkohet me përjetësimin, kështu që trupi shkon (bashkohet) me dheun, ndërsa shpirti me botën e përjetshme.

Për të përvëluarit e filozofisë, po u sjellim një argument tjetër për ekzistencën e shpirtit, prej tipareve, me të cilat karakterizohet lëvizja.

Lëvizja nuk mund të vrojtohet, vetëm se nga jashtë saj.

Nuk mundesh ta vësh re lëvizjen, ndërkohë që ti lëviz së bashku me të në të njëjtën trajektore, por patjetër duhet të kesh një prag të jashtëm, ku të qëndrosh dhe ta vrojtosh atë. Kështu ndodh një moment kur ti je në ashensor duke lëvizur dhe nuk mundesh ta dallosh, a është i ndaluar apo po lëviz, sepse ti je bërë pjesë e tij së bashku me të në lëvizjen e tij. Nuk mund ta dallosh këtë lëvizje, përveçse nëse shikon nga dera e ashensorit, jashtë, objekte të palëvizshme.

E njëjta gjendje është edhe me trenin që lëviz butë në dy shinat e tij. Nuk e dallon lëvizjen e këtij treni, ndërkohë që ti je në të, përveçse kur ai fillon të ndalet apo kur fillon të lëvizë, ose kur ti hedh shikimin nga dritarja dhe sheh jashtë rrugën e palëvizshme.

Në të njëjtën logjikë, ti nuk mund ta vrojtosh diellin, ndërkohë që ti qëndron mbi të, por mundesh ta vrojtosh prej hënës apo tokës, ashtu siç nuk mundesh ta vrojtosh tokën (lëvizjen e saj), ndërkohë që ti banon në të, por mund ta vrojtosh nga hëna.

Nuk mund ta përfshish një gjendje, përveç nëse del prej saj!

Për këtë arsye, nuk mundemi ta kuptojmë ecjen (kalimin) e kohës, sikur pjesa e të kuptuarit në ne të mos qëndrojë në pragun e shkëputur, jashtë kësaj lëvizjeje kohore të vazhdueshme, pra në "pragun e përjetësisë". Sikur të kuptuarit tonë të kërcente me akrepin e sekondave për çdo sekondë, ne nuk do të mund ta kuptonim kurrë këtë sekondë, e as do të shkonte i kuptuari ynë, ashtu siç shkojnë sekondat pa vënë re asgjë.

Ky është një rezultat (përfundim) i mahnitshëm, që do të thotë se, një pjesë e ekzistencës sonë është jashtë kornizës të kalimit kohor, pra "i përjetshëm", ai është i cili e vrojton kohën nga pragu i palëvizshmërisë dhe e kupton atë pa u përfshirë në të. Për këtë arsye, ajo nuk rritet, nuk plaket, nuk tretet dhe nuk zhduket. Ditën që trupi bie në tokë, kjo pjesë do të mbesë në gjendjen e saj, e gjallë, duke jetuar jetën e saj të veçantë, jo kohore, e kjo pjesë është shpirti!

Dhe, secili nga ne mund ta ndjejë brenda vetes së tij këtë ekzistencë shpirtërore në formën e prezencës, përjetësisë, personalitetit dhe qenies komplet të ndryshme nga ekzistenca lëndore, e ndryshueshme, e ndërrueshme, që rrah (pulson) me kohën jashtë saj.

Kjo gjendje e brendshme, të cilën e ndjejmë në çastet e zgjimit të brendshëm dhe të cilën e quajte gjendje prezence, ajo është çelësi i cili na orienton drejt ekzistencës shpirtërore brenda nesh dhe vendos dorën tonë tek ky mister, i cili quhet shpirt!

Argument tjetër për natyrën tonë shpirtërore,është ndjenja jonë e natyrshme për liri. Sikur të ishim trupa lëndor, brenda kornizave të jetës lëndore, ku ligjet e pashmangshme lëndore na mbërthejnë (na mbajnë), atëherë nuk do të kishte pasur kuptim kjo ndjenjë e natyrshme e lirisë.

Ne kemi shpirt, kështu që ai është mbi kohën, e kapërcen vdekjen dhe i kapërcen pashmangshmëritë lëndore.

Çfarë ka pas ringjalljes, pra?

Nuk është kthyer askush pas vdekjes, për të na treguar se çfarë i ka ndodhur atij. Nuk ka ardhur as dita e ringjalljes, për të paraqitur një argument të prekshëm apo dëshmi të gjallë.

E gjitha ajo, që mund të themi për çështjen e ringjalljes është, se ajo është një e vërtetë fetare, që e mbështet mendja dhe shkenca.

Përse e mbështet mendja dhe shkenca?

Sepse, dëshmitë e ekzistencës dhe dukuritë e saj, të gjitha së bashku na japin të kuptojmë, se ka një kthim në pikënisje dhe një cikël për çdo send. Pas ditës vjen nata, pastaj ajo rikthehet përsëri dhe vjen dita. Dielli lind pastaj perëndon, pastaj rikthehet dhe lind sërish.

Po ashtu, vera, vjeshta, dimri dhe pranvera. Pastaj rikthehen dhe përsëritet cikli nga fillimi, e kështu vjen vera, pastaj, vjeshta, pastaj dimri, etj.

Pas zgjimit dhe gjumit të natës rikthehemi dhe zgjohemi rishtas. Kjo mbështet atë, se pas gjumit të vdekjes, ka zgjim të ringjalljes, sepse ekziston rikthimi për çdo gjë. Allahu e quan Veten e Tij në Kur'an: El-Mubdi (Ai, i Cili i nis gjërat nga fillimi) dhe El-Muid (Ai, i Cili i rikthen gjërat edhe një herë).

"Siç ju ka filluar (nisur nga e para), do të riktheheni". – (Kur'ani, El-Araf: 29)

"E fillon krijimin, pastaj e rikthen (nga e para) atë". – (Kur'ani, Junus: 4)

A, nuk ciklohet (sillet rrotull) çdo gjë në univers nga thërrmija (atomi) deri te galaktika, madje edhe qytetërimet kanë

14

cikletetyre,edhehistoriakacikletesaj?!

Argument tjetër për ringjalljen është edhe rregulli (sistemi) i përkryer, i cili nuk ka as edhe një të metë të vogël, prej yjësive më të mëdha deri te thërrmija më e vogël, deri edhe elektroni, i cili nuk shikohet; do të gjejmë se rregulli dhe ligji mbizotërojnë në çdo gjë. Deri edhe elektroni pafundësisht i vogël, nuk mund të kalojë nga një orbitë në tjetrën në atom, përveç nëse jep apo merr një sasi energjie, që është e barabartë me lëvizjen e tij. Sikur të ishte pasagjer i trenit, që nuk mund të lëvizë pa biletë..!?

E, si mund të përfytyrojmë në këtë sistem (rregull perfekt), që vrasësi të shpëtojë apo zullumqari të arratiset prej ndëshkimit të tij, thjesht vetëm se ai është zhdukur? Mendja e përfytyron se, patjetër duhet të marrë ndëshkimin e tij të pashmangshëm dhe se patjetër ka një botë tjetër në të cilën do të bëhen llogaritë! Kështu e thotë drejtësia!

Ne jemi të krijuar për ta kërkuar drejtësinë, për ta dashur drejtësinë, për ta gjetur drejtësinë dhe për t'u përpjekur për ta arritur drejtësinë.

E, me gjithë këtë, drejtësia në dynja nuk ekziston!

Ashtu siç thonë mendimtarët, se nëse etja për ujë tregon për ekzistencën e ujit, atëherë patjetër etja për drejtësi tregon për ekzistencën e drejtësisë. Nëse nuk ekziston në dynja, atëherë patjetër ajo duhet të ketë një ditë dhe një orë ku do të shprazen peshoret!

Të gjitha këto shenja tregojnë dhe mbështesin, se ka një ringjallje, llogaridhënie dhe botë tjetër.

Besimtari, i cili beson në Kur'an, ai nuk ka nevojë për të gjitha këto argumentime, sepse ai është i sigurt në zemrën e tij dhe ka e shpëtuar veten prej debatit.

Pas gjithë kësaj, ka mbetur të pyesim: Çfarë është shpirti?

"Dhe, të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: Shpirti është çështje e Zotit tim, e nuk ju është dhënë dituri (për të), veçse pak!"- (Kur'ani, El-Isra: 85)

Ai është mister dhe askush nuk di gjë për të.

E habitshme është, se sa herë që përmendet shpirti në Kur'an, së bashku me të përmendet edhe shprehja: "Prej çështjes (urdhrit) të Zotit tim!"

"Ia dërgon Shpirtin, prej çështjeve (urdhrat) të Tij, ndaj kujt të dojë prej robërve të Tij". – (Kur'ani, Gafir: 15)

"Ia zbret melekët me Shpirtin, prej çështjeve (urdhrat) të Tij, ndaj kujt të

"Të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: Shpirti është çështje e Zotit tim, e nuk ju është dhënë dituri (për të), veçse pak!"

dojë prej robërve të Tij". – (Kur'ani, En-Nahl: 2)

"Dhe, kështu Ne të shpallën ty shpirtin prej çështjes Tonë". – (Kur'ani, Esh-Shura: 52)

Gjithmonë fjala: "Prej çështjes Tonë", "Prej çështjes së Tij", "Prej çështjes së Zotit tim", përmendet sa herë që përmendet fjala "Err-Rruh" (Shpirti).

A është çështja (urdhri) i Allahut shpirt?

A nuk ka thënë Allahu për Mesihun (a.s), se ai është: "Fjalë prej Tij, emri i tij është Mesih, Isa i biri i Merjemes". – (Kur'ani, Ali Imran: 45)

Fjala... Çështja... Shpirti... a, janë shprehje sinonime për një kuptim të vetëm?

Ato janë thjesht shenja treguese!

Dhe, askush nuk e di të vërtetën, përveçse i Gjithëdijshmi.

Pas kësaj, ka mbetur pyetja jote për prezencën e shpirtrave.

Prezenca e shpirtrave tek ne është një çështje e dyshimtë.

Është e dyshimtë, se ajo është dukuri e dhomës së errët, shkaku i saj prezantimi i shpirtit të filanit apo filanit.

Një mendimtar i madh, si p.sh. Henry Snyder thotë: Subkonshienca (nënndërgjegjja) për ndërmjetësin (ndërhyrësin) dhe fuqitë shpirtërore është për vetë ndërmjetësin (ndërhyrësin) e saj... dhe, asnjëherë nuk prezanton asgjë!

Mendimtarët indianë thonë: Ajo, e cila e ngatërron ndërmjetësin (ndërhyrësin) gjatë prezencës, janë shpirtrat e ulët, që dinë disa gjëra prej të vdekurve dhe i përdorin në tallje me mendjet e të pranishmëve dhe në qeshjen ndaj tyre.

Sufistët (gnostikët) myslimanë thotë, se ajo, e cila prezanton në këto kuvende (mexhlise) nuk është shpirti, por bashkëshoqëruesi (simetriku), e ai është xhin, i cili ka shoqëruar të vdekurin gjatë jetës së tij dhe ai për shkak të këtij bashkëshoqërimi, di disa të fshehta të tij; sepse xhini akoma jeton, ai vazhdon të jetë i gjallë edhe pas vdekjes së bashkëshoqëruesit të tij. Ai, është i cili prezanton kuvendet (mexhliset) dhe i përhap të fshehtat e bashkëshoqëruesit të tij, imiton zërin dhe veset e tij për t'u tallur me të pranishmit, siç bëjnë zakonisht xhinët për armikun e tyre njeri!

Ata thonë: Nëse ne i biem ziles së zyrës, ai i cili vjen është shërbyesi. Ndërsa zotërinjtë, nuk e lënë botën e tyre dhe të prezantojnë në këto gjëra naive, see e tillë është bota e shpirtrave. Ai, i cili prezanton këto kuvende (mexhlise) dhe i mashtron (tallet me) të pranishmit, janë shpirtrat e ulët dhe xhinët, e kushdo tjetër që janë në nivelin e tyre.

Ndërsa, shpirtrat njerëzor, ato janë në botë tjetër, që është bota "berzah" (e ndërmjetme) dhe nuk mundet t'i sjellim prezent, por ato ndoshta mund të lidhen me ata që donë përmes ëndrrave apo zgjuar, nëse plotësohen kushtet e përshtatshme.

Nga kuvendet (mexhliset) e shumta, në të cilat kemi marrë pjesë dhe prej të cilave kemi mbledhur eksperienca të veçanta për këto çështje, themi, se: Nuk ekziston asnjë argument i vetëm, se shkaku i dukurive të dhomave të errëta, është prezenca e shpirtrave të kërkuar!

Ndoshta, mendimi i sufistëve (gnostikëve) myslimanë ka qenë prej mendimeve më të komentuara për çfarë ndodhë. Meseleja (çështja) akoma vazhdon të jetë duke u hulumtuar.

Për fat të keq, manipulimet në këto çështje janë më shumta, se sa të vërtetat. Dhe, fjala e fundit, akoma nuk është thënë!

Padyshim, se ti do të qeshësh ndaj këtyre fjalëve si, xhin, shpirtra të ulët, bashkëshoqërues...

Je i justifikuar, sepse, nëse nuk beson në shpirtin tënd, atëherë si mund të pritet prej teje të besosh në shpirtin tim!

Nëse nuk beson në Allah, atëherë si mundet të pritet prej teje të besosh në shejtanët (xhinët) e Tij.

Megjithatë, sikur të kishe lindur që njëqind vite më parë dhe të të kishte ardhur dikush dhe të fliste për rreze të padukshme që përshkojnë hekurin, imazhe të ndryshme që transmetohen në ajër duke kaluar oqeane në më pak se një sekondë dhe astronautin që ecë mbi sipërfaqen e hënës.., a nuk do të kishe qeshur, do shkriheshe dhe do bie në shpinë, shumëfish më tepër se sa po qeshesh tani?

(Marrë nga libri:
DIALOG ME MIKUN TIM ATEIST)

Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja

MINISTRJA E BRENDSHME GJERMANE NANCY FAESER THOTË SE ISLAMI I PËRKET GJERMANISË

Ministrja e Brendshme gjermane Nancy Faeser tha për të përditshmen gjermane "Süddeutsche Zeitung" se Gjermania është një vend migrimi, ndërsa shtoi se migrimi për motive punësimi duhet të lehtësohet.

Faeser tha për të përditshmen gjermane "Süddeutsche Zeitung" se Gjermania është një vend migrimi, ndërsa shtoi se migrimi për motive punësimi duhet të lehtësohet.

"Ne jemi një vend migrimi dhe në fund duam të jemi një vend me harmoni të mirë. Ne duam të mirëpresim njerëzit që kanë pranuar nënshtetësinë gjermane. Nga ana tjetër, ne duam të përshpejtojmë kthimin dhe largimin vullnetar të atyre që nuk mund të qëndrojnë. Nuk mund të qëndrojmë pa bërë gjë dhe të shikojmë njerëzit duke u mbytur në dete. Ne duhet të krijojmë rrugë të ligjshme për migracion", tha ministrja Faeser.

"Islami, natyrisht, i përket Gjermanisë. Ai ka qenë pjesë e jetës kulturore në Gjermani për shumë vite", shtoi ajo.

Faeser trajtoi edhe debatin për kuotat e migracionit, duke theksuar se edhe Gjermania ka nevojë për migrim në shkallë të gjerë për tregun e punës.

Ajo tha se janë duke përgatitur një plan veprimi kundër ekstremizmit të djathtë dhe se ekstremistët do të hiqen nga shërbimi publik shumë shpejt.

(www.trt.net.tr)

NGECJA NË BORË NË STAMBOLL: RABINI IZRAELIT QË U STREHUA NË XHAMI

Rabini izraelit Israel Elbom u ndodh në Turqi, më saktë në Stamboll gjatë reshjeve të dendura të borës këtë javë, por u ndihmua nga xhandarmëria lokale, pas së cilës ai gjeti strehim në një nga xhamitë e qytetit gjigand turk.

Rabini Elbom mbërriti në Stamboll për të punuar si kontrollues për certifikimin e ushqimit kosher, i cili konsiderohet certifikim hallall nga hebrenjtë. Kosher do të thotë ushqim i përshtatshëm për konsum njerëzor në përputhje me ligjin hebre. Ushqimi kosher duhet të jetë i certifikuar, pra duhet të ketë certifikatë.

Pasi kreu detyrën e tij, Elbom u drejtua për në aeroport, por mbeti i "mbërthyer" në rrugë për shkak të reshjeve të mëdha të borës.

Atij iu desh të priste në automjet për 15 deri në 2 orë pas mesnate, dhe më pas me ndihmën e xhandarmërisë u dërgua në një stacion policie aty pranë, pas së cilës u vendos në një xhami afër aeroportit të Stambollit për të pritur që të kthehej moti i përshtatshëm për fluturim drejt Izraelit.

Aty, ai ndau me besimtarët përvojën e faljes së namazit të sabahut, duke e thënë këtë dhe në mediat izraelite.

Pasi moti u përmirësua dhe rrugët në Stamboll u hapën, Elbom u vendos në një hotel dhe shpejt u kthye me aeroplan në Izrael.

Në një intervistë për AA, rabini 62-vjeçar izraelit tha se ka vizituar shumë qytete turke për shkak të punës së tij, duke shtuar se ndihet gjithmonë mirë dhe rehat gjatë udhëtimit për në Turqi.

"Kam udhëtuar për vite në shumë qytete si Ankara, Izmir dhe Adana. Ndihem rehat sa herë që udhëtoj në këtë vend. Takoj njerëz shumë të sjellshëm që ju përshëndesin me buzëqeshje. Punoj si konsulente për certifikimin e ushqimit kosher, ndaj vij këtu shpesh," tha Elbom.

(kohaislame.com)



MYFTIU TAKOI IMAMËT NË PRAG TË TRE MUAJVE TË MIRË

Paraditën e së enjtes, më 13 janar 2022, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, takoi imamët e Myftinisë Shkodër, me të cilët diskutoi për imazhin e imamit dhe misionin që ai mban mbi supe.

Myftiu theksoi se imami është pikë referimi në shoqëri dhe duhet të përpiqet me të gjitha mundësitë e tij për të ruajtur këtë pozitë të lartë dhe përgjegjësitë e tij.

Takimi, që është i pari në prag të Tre Muajve të Mirë 1443, u kurorëzua edhe me dhuratën e çmuar për imamët e Myftinisë Shkodër, ardhur nga Zyra e Këshilltarit për Çështjet Fetare në Ambasadën e Turqisë, në Tiranë.

Myftiu falënderoi atasheun Bekir Yanılmaz, që falë bashkëpunimit të vazhdueshëm u arrit pajisja e krejt imamëve me kostumin e ceremonive fetare.

Një fjalë përshëndetëse mbajti edhe koordinatori i Zyrës së Çështjeve Fetare në Ambasadën e Turqisë, z. Ömer Baloğlu, i cili shprehu kënaqësinë e tij për këtë takim dhe gatishmërinë për vijimësinë e bashkëpunimeve të dobishme në shërbim të komunitetit.

Pas një kërkese të bërë nga Myftinia e qytetit të Shkodrës, Zyra e Këshilltarit të Çështjeve Fetare pranë ambasadës turke në Tiranë, i dorëzoi imamëve veshjen fetare të përbërë nga një xhybe dhe çallmë, si dhuratë e mundësuar nga Fondacioni i Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë dega e qytetit Tokat.

Në fjalën e tij Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari falënderoi zyrën tonë që falë bashkëpunimit të vazhdueshëm u arrit pajisja e të gjithë imamëve me veshjen fetare.

Koordinatori i Zyrës së Çështjeve Fetare në Ambasadën e Turqisë, z. Ömer Baloğlu, në fjalën e tij përshëndetëse falënderoi Fondacionin e Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë dega e qytetit Tokat. Dhe shprehu kënaqësinë e tij për këtë takim dhe gatishmërinë për vijimësinë e bashkëpunimeve të dobishme në shërbim të komunitetit.

TAKIM PUNE ME MYFTILERËT E ZONËS SHKODËR

Paraditën e së shtunës, më 15 janar 2022, në qytetin e Shkodrës u organizua takimi i parë periodik për vitin 2022, i myftilerëve të zonës Shkodër, nën drejtimin e nënkryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Taulant Bica.

Në takim ishin të pranishëm myftilerët e nderuar të Shkodrës, Malësisë së Madhe, Pukës, Kurbinit dhe Lezhës. Ndërkohë, për shkak të kushteve të motit dhe largësisë, mungonin myftilerët e Tropojës, Kukësit dhe Hasit.

Gjatë këtij takimi u diskutua rreth kalendarit të aktiviteteve të vitit 2022, ku myftilerët e nderuar paraqitën detaje me vlerë të këtij kalendari, sikurse u diskutua gjatë rreth problematikave të shumta të disa zonave, ku duhet të intensifikohet bashkëpunimi për të ruajtur ritmin e aktivitetit, për hapjen e xhamive dhe afrimin e rinisë.

Theksi u vu në veçanti tek organizimet me rininë, gjallërimin e hytbeve të xhumasë, përzgjedhjen e mesazheve dhe ndjekjen me vëmendje të nevojave të ka xhemati dhe xhamitë tona.



Pejgamberi (a.s)

"Tregtari besnik,

i besueshëm

dhe mysliman

është së bashku

me profetët,

të sinqertët

dhe me dëshmorët

në ditën e kiametit!"

(Transmetuar nga Ibn Maxheh dhe Hakimi)

MYFTIU: “NE NUK JEMI YMET I DËSHTIMIT DHE ISLAMIN NUK NA E MËSOJNË TË PAFETË!”

Ditën e shtunë, më 22 janar 2022, pas namazit të akshamit, në vigjilje të Muajve të Mirë, Myftinia Shkodër zhvilloi një takim me të rinjtë e xhamisë së Zuesit.

I pranishëm në këtë aktivitet ishte Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili ligjëroi rreth temës: “Të rinj që nuk thyhen”.

Myftiu uroi të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre në këtë takim me vlera dhe dobiprurëse, sidomos për brezin e ri, i cili duhet të jetë në qendër të vëmendjes nga të gjithë aktorët dhe faktorët institucional.

Korrektësia dhe vlera e kohës, shfrytëzimi i saj dhe qëndrueshmëria në besim ishin disa nga elementët bazë që Myftiu Sytari trajtoi në ligjëratën e tij.

Ai kërkoi që besimtarët t’i çmojnë ato përmes sjelljeve të tyre, edukatës dhe shembullit në shoqëri, duke u dëshmuar njerëz me vullnet të fortë për të ndërtuar vlera e dhuruar pozitivitet në jetë.

“Mos e humb shpresën, sepse ti je në kontakt të vazhdueshëm me Allahun. Si mund të humbësh ti? Ti që bën dhikr çdo ditë! Ti që thua: ‘Allahu ekber’ me dhjetëra herë në ditë...

Ne, në mënyrë kategorike nuk e njohim frikën. Ne nuk e njohim thyerjen në jetë, sepse ne ecim përpara; në biznes, në politikë, në marrëdhëniet sociale, në familje, në shkollë dhe kudo që jemi.

Ne ecim përpara, sepse ne nuk jemi ymeti i të thyerve. Ne nuk thyhemi asnjëherë! Ne, jemi ashtu siç ka thënë Allahu: ‘Qëndroni dhe kujtoni shumë Zotin’. Dhe rezultati pas qëndrimit të palëkundur dhe përmendjes së Allahut është sipas Kuranit: ‘Në mënyrë që të triumfoni’. Triumf garant!...” – tha Myftiu.

Pas shumë këshillave dhe mesazheve të ndryshme, Myftiu i Shkodrës në fund të bisedës së tij iu drejtua të rinjve të pranishëm me këto fjalë: “Ne besimtarët muslimanë nuk jemi ymet i dështimit, ne jemi ymet i forcës, jemi ymet i organizimit, i zhvillimit, i ecjes përpara, jemi ymet i çdo të mire.

Është haram për ne, të qëndrojmë prapa, të na drejtojnë të tjerët në fenë tonë. Është e pafalshme për ne të na e mësojnë fenë tonë të pafetë si dhe të na udhëzojnë në rrugën tonë të pafetë!

Është e patolerueshme të na tregojnë se si me u sjellë ne fenë tonë ta pafetë, dhe të na tregojnë të tjerët vijat e kuqe, këtu bën e aty nuk bën, të pafetë! Jo, kjo nuk është feja jonë, ky nuk është modeli ynë, kjo nuk është rruga jonë!

Rruga jonë është: rruga e mbarësisë së Allahut (xh.sh), e të mbështeturit tek Zoti dhe të punuarit fort pa e kthyer kokën pas dhe pa u ndaluar në asnjë moment!” – citoi më tej Imam Muhamed Sytari, duke përfunduar ligjëratën e tij para të rinjve të xhamisë Zues.

Kujtojmë se cikli i ligjëratave dhe aktiviteteve të tjera të larmishme në kudër të Tre Muajve të Mirë do të vazhdojnë edhe në xhami të tjera të zonës Shkodër.

MEJTEPI I IM... XHAMIA SHTOJ I RI

Pak histori:

- Xhamia Shto i Ri, ndodhet në Njësinë Administrative “Rrethina”, Shkodër.

- Përbëhet prej 200 familjeve myslimane.

- Fiset më të njohura janë: Dekovi, Ivziku, Piraniqi, Ramja, Rama, Kapija, etj.

- Xhamia e Shtojit të Ri, e cila gjatë sistemit famëkeq monist, ka qenë sallë kulture, Ndërsa, pas vitit 1990 u kthye në identitetin e saj si xhami me minare për t’u rindërtuar po në të njëjtin vend, në vitin 2015.

- Në xhaminë(e vjetër dhe më pas të re) Shtoj i Ri gjatë viteve të lirisë së besimit pas 1990 e deri më sot kanë

shërbyer imamë dhe mësues të mejtepeve: Orhan Ademi, Vullnet Begaj, Astrit Hoxha, Ylli Buraniqi, Fatjon Duraj dhe imami aktual Ervin Juku.

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar rregullisht rreth 12 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami në periudha të ndryshme nga viti 2002 -2022 është rreth 280 nxënës dhe nxënëse.

Takimi me nxënësit:

Sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, në vazhdën e vizitave dhe takimeve me nxënësit e xhamive që frekuentojnë rregullisht kurset-mejtepet e mësim-besimit, ditë e shtunë, më 30 janar 2022 drejtuesi dhe inspektori i arsimit, teologu Arben Halluni zhvilloi një takim me nxënësit e kursit fetar në xhaminë Shtoj i Ri.

Fillimisht teologu Halluni u mbajti një bisedë, duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që ato mbartin në përçimin te brezi i ri i mësimeve të vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit dhe krijesat e Zotit.

Më pas, drejtuesi arsimit shpërndau bazë materiale (tekste mësimore, fletore, rezerva, etj) dhe më pas evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi dhe imami, H. Ervin Juku.

Gjatë këtij takimi u prezantua edhe një plan-program i disa veprimtarive arsimore dhe argëtuese që do të zhvillohen në tre muajt e parë të vitit 2022, midis xhamive të kësaj njësie administrative.

DITËT DHE NETËT E SHËNUARA ISLAME PËR VITIN 2022 (1443-1444 HIXHRI)

E Enjte	03.02.2022	Fillimi i Tre Muajve të Mirë
E Diel	27.02.2022	Nata e Mirë e dytë - Israja dhe Miraxhi
E Enjte	17.03.2022	Nata e Mirë e tretë - Gjysma e Shabanit
E Shtunë	02.04.2022	Dita e parë e agjërimit të Ramazanit
E Mërkurë	27.04.2022	Nata e Kadrit
E Hënë	02.05.2022	Dita e parë e Fitër Bajramit
E Xhuma	08.07.2022	Dita e Arafatit
E Shtunë	09.07.2022	Dita e parë e Kurban Bajramit
E Shtunë	30.07.2022	Dita e parë e Vitit të Ri Hixhri 1444
E Hënë	08.08.2022	Dita e Ashurasë
E Xhuma	07.10.2022	Ditëlindja e Pejgamberit (a.s) (Mevludi Sherif)

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek